



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 8 qershor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të
Njohura nga Gjithkush dhe Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera
me Shtojcën 1, publike, dhe Shtojcën 2, konfidenciale**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtjes së të akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (“Trupi Gjykses”) lëshon këtë vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për konstatim gjyqësor të fakteve të njohura nga gjithkush dhe fakteve të shqyrtuara në procese të tjera.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 30 shtator 2022, Trupi Gjykses urdhëroi palët që të bënin të ditur nëse do të parashtronin kërkesë – bashkërisht ose më vete – për konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera në bazë të rregullës 157(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe, nëse po, kur do të parashtrohej kërkesa ose kërkesat, dhe në lidhje me sa fakte.¹

2. Më 10 tetor 2022, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) njoftoi Trupin Gjykses se synonte të kërkonte konstatim gjyqësor për jo më shumë se 150 fakte të shqyrtuara në procese të tjera në bazë të rregullës 157(2) të Rregullores.²

3. Më 10 tetor 2022, Mbrojtja e z. Pjetër Shala (përkatësisht, “Mbrojtja” dhe “i akuzuari”) parashtroi se nuk ka ndër mend të bëjë kërkesë për konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera dhe se pret që ZPS-ja të paraqesë prova në gjykim për vërtetimin e akuzave në tërësi.³

¹ KSC-BC-2020-04, F00289, Trupi Gjykses I, *Vendim për Caktimin e Datave të Konferencave Përgatitore për Gjykimin dhe për Parashtrime nga Palët*, 30 shtator 2022, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, para. 9, pika 7.

² KSC-BC-2020-04, F00303, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë para Konferencës Përgatitore për Gjykimin*, 10 tetor 2022, konfidenciale, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 3, konfidenciale, para. 35. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 11 tetor 2022, F00303/RED2.

³ KSC-BC-2020-04, F00305, Mbrojtja, *Parashtrime të Mbrojtjes sipas Urdhrit për Mbajtjen e Konferencave Përgatitore për Gjykimin*, 10 tetor 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, para. 20. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00305/RED.

4. Më 24 shkurt 2023, Trupi Gjykses udhëzoi ZPS-në që deri më 14 prill 2023 të dorëzonte, nëse dëshironte, kërkesë për konstatim gjyqësor të fakteve të njohura dhe fakteve të shqyrtuara në procese të tjera sipas rregullës 157(1) dhe (2) të Rregullores.⁴
5. Më 14 prill 2023, ZPS-ja parashtroi mocion për konstatim gjyqësor të fakteve të njohura dhe fakteve të shqyrtuara në procese të tjera ("Kërkesa e ZPS-së").⁵
6. "Më 28 prill 2023, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Mbrojtjes për zgjatjen e afatit për parashtrimin e përgjigjes ndaj Kërkesës së ZPS-së dhe urdhëroi Mbrojtjen që të dorëzonte përgjigjen deri më 10 maj 2023.⁶
7. Më 11 maj 2023, Mbrojtja dorëzoi përgjigje ndaj Kërkesës së ZPS-së ("Përgjigjja e Mbrojtjes").⁷ Mbrojtësi i Viktimave nuk parashtroi përgjigje.
8. Më 16 maj 2023, ZPS-ja iu kundërpërgjigj Përgjigjes së Mbrojtjes ("Kundërpërgjigjja e ZPS-së").⁸

II. PARASHTRIMET

9. ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses të bëjë konstatim gjyqësor të 17 fakteve të njohura nga gjithkush ("faktet e njohura të propozuara")⁹ dhe 61 fakteve të shqyrtuara në procese të tjera ("faktet e shqyrtuara të propozuara"), të cilat janë relevante për

⁴ KSC-BC-2020-04, F00434, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 24 shkurt 2023, konfidencial, para. 72-73. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00434/RED.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00484, Prokurori i Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Njohura dhe Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 14 prill 2023, publik, me Shtojcën 1, publike, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00495, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit (F00494)*, 28 prill 2023, publik, para. 9(b).

⁷ KSC-BC-2020-04, F00507, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Mocionit të Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Njohura dhe Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 11 maj 2023, publike, me Shtojcën 1, publike dhe Shtojcën 2, konfidenciale.

⁸ KSC-BC-2020-04, F00512, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimit KSC-BC-2000-04/F00507*, 16 maj 2023, publike.

⁹ Kërkesa e ZPS-së, para. 1, 29 dhe Shtojca 1.

çështjen gjyqësore dhe janë nga procese të përfunduara në gjykatat e Kosovës dhe në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ").¹⁰ ZPS-ja argumenton se faktet e propozuara përmbushin kriteret përkatëse të rregullës 157(1) dhe (2) të Rregullores dhe se konstatimi gjyqësor i tyre do të mundësojë administrim efikas të procesit gjyqësor, është në interes të drejtësisë dhe respekton të drejtat e të akuzuarit për gjykim të drejtë, publik dhe të shpejtë.¹¹

10. Mbrojtja kundërshton Kërkesën e ZPS-së dhe argumenton se faktet e propozuara nuk përmbushin kriteret përkatëse të rregullës 157(1) dhe (2) të Rregullores.¹² Mbrojtja argumenton më tej se numri i madh i fakteve të propozuara për konstatim gjyqësor është i tepruar duke mbajtur parasysh kuadrin relativisht të vogël të kësaj çështjeje gjyqësore,¹³ dhe se konstatimi gjyqësor i fakteve të propozuara do të ndikonte të konsiderueshëm në të drejtat e të akuzuarit për t'u prezumuar i pafajshëm, për gjykim të drejtë dhe për të ballafaquar "akuzuesit e tij" dhe dëshmitarët kundër tij.¹⁴

11. Në Kundërpërgjigje, ZPS-ja argumenton ndër të tjera se numri i fakteve të propozuara nuk është i tepruar dhe se Mbrojtja nuk ka demonstruar që konstatimi gjyqësor i tyre do të komprometonte në ndonjë mënyrë drejtësinë dhe shpejtësinë e gjykimit.¹⁵

¹⁰ Kërkesa e ZPS-së, para. 1, 29 dhe Shtojca 2.

¹¹ Kërkesa e ZPS-së, para. 1, 5, 8 dhe në vijim.

¹² Përgjigja e Mbrojtjes, para. 3, 13.

¹³ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 12.

¹⁴ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 14.

¹⁵ Kundërpërgjigja e ZPS-së, para. 2-3.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

12. Trupi Gjykses mbështetet në nenin 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 9(5)(b), 116(1) dhe 157(1) e (2) të Rregullores.

IV. ANALIZË

A. ASPEKTE PARAPRAKE

13. Trupi Gjykses para së gjithash vë në dukje se Përgjigjja e Mbrojtjes u dorëzua pas përfundimit të afatit.¹⁶ Duke qenë se vonesa është minimale, Trupi Gjykses vendos *proprio motu* ta pranojë si të vlefshme sipas rregullës 9(5)(b) të Rregullores.

B. FAKTET E NJOHURA

1. Parashtrimet e palëve

14. Sipas ZPS-së, faktet e njohura të propozuara prej saj (faktet 1-17) janë fakte të njohura gjeografike dhe historike të pakundërshtuara. Ato janë logjikisht të pakundërshtueshme dhe janë aq të njohura ose të vërtetueshme përmes referencave ndaj burimeve autentike, sa që provat për ekzistencën e tyre janë të panevojshme. Sipas ZPS-së, faktet e lartpërmendura janë relevante për çështjen gjyqësore, nuk përmbajnë cilësime apo konstatime juridike, dhe nuk janë për vërtetimin e përgjegjësisë penale të të akuzuarit. Konstatimi gjyqësor i këtyre fakteve do të shpejtojë gjykimin, pa dëmtuar të drejtat e të akuzuarit.¹⁷

¹⁶ *Shih* para. 6-7 më lart.

¹⁷ Kërkesa e ZPS-së, para. 5.

15. Mbrojtja kundërshton të gjitha faktet e njohura të propozuara (faktet 1-17), dhe parashtrohet se ZPS -ja nuk ka demonstruar relevancën e tyre për këtë proces gjyqësor.¹⁸ Sipas Mbrojtjes, kërkesa që Trupi Gjyqësor të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të lartpërmendura pa demonstruar mjaftueshëm relevancën e tyre do ta mbingarkonte dosjen e provave të çështjes dhe nuk duhet të lejohet, veçanërisht duke marrë parasysh se faktet e njohura, pas konstatimit gjyqësor të tyre, shërbejnë si prova të pranuar përfundimisht.¹⁹ Krahas kësaj, Mbrojtja parashtrohet se faktet 3-17 të propozuara si fakte të njohura, nuk mund të identifikohen lehtësisht duke iu referuar burimeve të besueshme dhe autentike, sepse u referohen aktgjykimeve përmbajtja e të cilëve “nuk kontribuon për të kuptuar nëse faktet e propozuara u kontestuan, apo ishin të bazuara në fakte për të cilat palët ishin pajtuar”.²⁰ Kjo, sipas Mbrojtjes, e pengon Trupin Gjyqësor që të bëjë konstatim në lidhje me fakte që janë aq të njohura dhe logjikisht të pakundërshtueshme, sa që për to duhet bërë konstatim gjyqësor.²¹

2. Konstatim

16. Sipas rregullës 157(1) të Rregullores, Trupi Gjyqësor nuk kërkon vërtetimin e fakteve të njohura nga gjithkush, por bën konstatim gjyqësor të tyre. Trupi Gjyqësor gjykon se ato janë fakte që dihen nga të gjithë ose janë logjikisht të pakundërshtueshme meqenëse janë të pranuar përgjithësisht, të njohura botërisht ose gjerësisht, ose të përcaktuara qartë apo lehtësisht të vërtetueshme përmes referimit në burime të disponueshme dhe autentike.²² Shembujt përfshijnë fakte historike ose

¹⁸ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 16-17 dhe referencat shoqëruese; *shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së Mbrojtjes.

¹⁹ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 17.

²⁰ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 18; *shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së Mbrojtjes.

²¹ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 18.

²² *Shih*, ICTR, *Prosecutor v. Semanza*, ICTR-97-20-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 20 May 2005, para. 194 (“Aktykimi i Apelit Semanza”); *Prosecutor v. Semanza*, ICTR-97-20-T, Trial Chamber, [Decision on the Prosecutor’s Motion for Judicial Notice and Presumptions of Facts Pursuant to Rules 94 and 54](#), 3 November 2000, para. 23-25 (“Semanza Decision”); ICTY, *Prosecutor v. Ratko Mladić*, IT-09-92-PT, Trial

gjeografike të përgjithshme,²³ si dhe fakte që janë "përgjithësisht të njohura brenda juridiksionit territorial të një gjykate".²⁴

17. Për të bërë konstatim gjyqësor të tyre, faktet e njohura duhet të përmbushin kriteret në vijim: (i) janë relevante për çështjen që shqyrtohet; (ii) janë logjikisht të pakundërshtueshme; (iii) janë të përcaktuara mjaftueshëm qartë; (iv) nuk përmbajnë konstatime ose cilësime që në thelb janë të llojit juridik; dhe (v) nuk janë për vërtetimin e përgjegjësisë penale të të akuzuarit.²⁵ Faktet e njohura nga gjithkush, pas konstatimit gjyqësor të tyre, përcaktohen përfundimisht dhe nuk mund të kundërshtohen gjatë gjykimit.²⁶

18. Trupi Gjykues shqyrtoi me kujdes secilin prej fakteve të njohura të propozuara dhe i vlerësoi kundrejt kriterëve të lartpërmendura. Trupi Gjykues është bindur se të gjitha faktet e njohura të propozuara, sikurse janë formuluar nga ZPS-ja, i përmbushin këto kriterë. Në këtë kontekst, në kundërshtim me argumentin e Mbrojtjes, Trupi Gjykues konstaton se faktet e njohura të propozuara janë logjikisht të pakundërshtueshme. Krahas burimeve që rendit ZPS-ja, këto fakte mund të identifikohen lehtësisht përmes referimit në një sërë burimesh të disponueshme

Chamber, [First Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts](#), 28 February 2012, para. 17 ("Ratko Mladić First Decision"); ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-1249, Trial Chamber VII, [Decision on Prosecution Motion for Clarification of Rule 68\(3\) Direction in Conduct of Proceedings Decision](#), 15 September 2015, para. 5.

²³ ICTR, *Semanza*, Appeal Judgment, para. 194; *Semanza* Decision, para. 23; ICTY, *Ratko Mladić* First Decision, para. 17; ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber II, [Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Facts of Common Knowledge Pursuant to Rule 94\(a\)](#), 26 September 2006, para. 13 ("Popović Decision on Facts of Common Knowledge"); SCSL, *Prosecutor v. Taylor*, SCSL-03-01-T-370, Trial Chamber II, [Decision on the Prosecution Motion for Judicial Notice](#), 7 December 2007, para. 12 ("Taylor Decision").

²⁴ *Semanza* Decision, para. 24.

²⁵ SCSL, *Prosecutor v. Norman et al.*, SCSL-04-14-AR73, Appeals Chamber, [Fofana - Decision on Appeal against "Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice and Admission of Evidence"](#), 16 May 2005, para. 28 ("Norman Decision"); *Taylor* Decision, para. 13. *Shih gjithashtu*, *Popović* Decision on Facts of Common Knowledge, para. 19.

²⁶ *Norman* Decision, para. 30-32.

publikisht, ndër të cilat Rezoluta të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, raporte dhe deklarata për shtyp të organizatave ndërkombëtare (ku përfshihen edhe ato të përmendura në faktet e njohura të propozuara), dhe një numër botimesh akademike. Trupi Gjykses vlerëson se këto ngjarje historike janë tashmë të pakundërshtueshme dhe njihen gjerësisht, të paktën brenda juridiksionit territorial të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Për më tepër, të gjitha faktet e njohura të propozuara janë relevante për çështjen gjyqësore sepse ofrojnë kontekst historik për ngjarjet dhe akuzat në këtë çështje. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se ato nuk përmbajnë cilësime juridike dhe nuk kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale të të akuzuarit. Trupi Gjykses gjykon se konstatimi gjyqësor i fakteve të propozuara nuk do të cenojë të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë dhe njëkohësisht do të shmangë debate të panevojshme lidhur me ngjarje historike tashmë të vërtetuara.

19. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses bën konstatim gjyqësor të fakteve të njohura të propozuara (faktet 1-17), në listën e Shtojcës 1 të Kërkesës së ZPS-së, që është përfshirë edhe si Shtojca 1 e këtij vendimi.

C. FAKTET E SHQYRTUARA NË PROCESE TË TJERA

1. Parashtrimet e palëve

20. ZPS-ja argumenton se të gjitha faktet e shqyrtuara në procese të tjera që ka propozuar (faktet 1-61): (i) janë relevante për këtë proces sepse kanë të bëjnë me ekzistencën e konfliktit të armatosur në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës (së Konfirmuar),²⁷ përdorimin e fabrikës së metalit në Kukës nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës ("UÇK"), veprat penale të kryera aty, dhe praninë dhe sjelljen e anëtarëve të

²⁷ Kërkesa e ZPS-së, para. 9-10.

tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët ("NKP") përveç të akuzuarit, sipas akuzave të paraqitura në Aktakuzë (të Konfirmuar);²⁸ (ii) nuk lidhen me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit;²⁹ (iii) janë të dallueshme, konkrete dhe të identifikueshme, veçanërisht kur shihen brenda kontekstit, duke iu referuar kuadrit gjeografik dhe kohor të akuzave në aktgjykimet përkatëse dhe në lidhje me faktet shoqëruese të shqyrtuara të propozuara;³⁰ (iv) nuk ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga formulimi i tyre në aktgjykimet nga burojnë dhe përshtatjet që mund të ketë bërë ZPS-ja nuk kanë ndryshuar thelbin e fakteve nga formulimi origjinal i tyre;³¹ (v) nuk janë të paqarta apo çorientuese në kontekstin në të cilin janë paraqitur në Kërkesën e ZPS-së, dhe përshtatjet e bëra nga ZPS-ja shoqërohen me poshtëshënime shpjeguese dhe referenca ndaj tekstit origjinal;³² (vi) janë identifikuar me saktësi të mjaftueshme;³³ (vii) nuk përmbajnë konstatime ose cilësime juridike;³⁴ (viii) nuk bazohen në marrëveshje midis palëve në proceset origjinale;³⁵ dhe (ix) nuk janë në proces apeli ose rishikimi.³⁶

21. Mbrojtja përgjigjet se faktet e shqyrtuara në procese të tjera (faktet 1-61) që propozohen: (i) nuk kanë relevancën e kërkuar për aspektet që po shqyrtohen në këtë proces gjyqësor – dhe në lidhje me këtë u referohet konkretisht fakteve të propozuara 1-33 në Shtojcën 2 të Kërkesës së ZPS-së;³⁷ (ii) nuk janë të dallueshme, konkrete dhe të identifikueshme – duke parashtruar konkretisht se faktet e propozuara 1, 2, 4, 8, 10-34, 37, 45, 47, 53-55 dhe 59-61 në Shtojcën 2 të Kërkesës së ZPS-së, janë “tepër të gjera,

²⁸ Kërkesa e ZPS-së, para. 11.

²⁹ Kërkesa e ZPS-së, para. 13-15.

³⁰ Kërkesa e ZPS-së, para. 16-17.

³¹ Kërkesa e ZPS-së, para. 18-20.

³² Kërkesa e ZPS-së, para. 21-22.

³³ Kërkesa e ZPS-së, para. 23-24.

³⁴ Kërkesa e ZPS-së, para. 25.

³⁵ Kërkesa e ZPS-së, para. 26.

³⁶ Kërkesa e ZPS-së, para. 27.

³⁷ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 3 dhe 24.

të mjegullta, tendencioze, të hollësishme, përsërisin prova të tjera, ose janë pretendime të pabazuara;³⁸ (iii) janë të mjegullta, të pasakta ose çorientuese kur shihen jashtë kontekstit të aktgjykimeve origjinale – dhe në lidhje me këtë përmend faktet e propozuara 52, 53 dhe 55;³⁹ (iv) lidhen me veprimet dhe sjelljen e pretenduar të të akuzuarit – dhe në lidhje me këtë nënvizon faktet e propozuara 34-61;⁴⁰ (v) kanë të bëjnë me aspekte që kanë rëndësi kyçe në këtë çështje gjyqësore – dhe në lidhje me këtë nënvizon faktet e propozuara 36, 41, dhe 51-61;⁴¹ (vi) përdorin formulim që është thelbësisht i ndryshëm nga formulimi në aktgjykimet origjinale – dhe në lidhje me këtë nënvizon veçanërisht faktin e propozuar 52;⁴² (vii) kanë të bëjnë me aspekte për të cilat palët nuk pajtohen – dhe në lidhje me këtë nënvizon veçanërisht faktet e propozuara 36, 41, dhe 51-61;⁴³ dhe (viii) burojnë nga konstatime të bëra në procese gjyqësore ku interesat e të akuzuarve nuk u përfaqësuan, çka e bën të padrejtë përfshirjen e tyre në këtë proces.⁴⁴ Mbrojtja i kërkon Trupit Gjyqësor të hedhë poshtë të gjitha faktet e shqyrtuara të propozuara.⁴⁵

22. Në Kundërpërgjigje, ZPS-ja kundërshton “standardin e formuluar në mënyrë të gjerë” prej Mbrojtjes se çfarë përbën “veprimet dhe sjelljen” e të akuzuarit.⁴⁶ Në përgjigje të argumentit të Mbrojtjes se disa nga faktet e shqyrtuara të propozuara janë “me rëndësi kyçe” për këtë çështje gjyqësore, ZPS-ja gjithashtu parashtroi se Trupi Gjyqësor nuk e ka të ndaluar në vetvete të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve që lidhen me thelbin e çështjes gjyqësore.⁴⁷ Konkretisht, në lidhje me faktet e shqyrtuara të

³⁸ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 25 dhe 29-30.

³⁹ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 27-28 dhe 31.

⁴⁰ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 3, 20-22 dhe 33.

⁴¹ Përgjigja e Mbrojtjes para. 23, dhe 32-34.

⁴² Përgjigja e Mbrojtjes, para. 3 dhe 31.

⁴³ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 32-34.

⁴⁴ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 3 dhe 35.

⁴⁵ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 37.

⁴⁶ Kundërpërgjigja e ZPS-së, para. 4-8.

⁴⁷ Kundërpërgjigja e ZPS-së, para. 10-11.

propozuara 51-61, ZPS-ja argumenton se këto janë fakte në lidhje me krimet që kanë ndodhur dhe jo për vërtetimin e veprimeve dhe sjelljes së anëtarëve të pretenduar të NKP-së në për realizimin e qëllimit të përbashkët.⁴⁸ Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se shumë prej fakteve të propozuara janë tepër të gjera ose të mjegullta, ZPS-ja kundërpërgjigjet se: (i) kjo duhet të përcaktohet duke mbajtur parasysh aktgjykimin dhe aktakuzën në gjykimin origjinal, si edhe faktet shoqëruese të propozuara; dhe se (ii) sido që të jetë, Trupi Gjykses ka kompetencën diskrecionale për të korrigjuar paqartësinë e faktit, duke shtuar data apo zëvendësuar fjalë.⁴⁹

2. Konstatim

23. Fillimisht, Trupi Gjykses thekson se rregulla 157(2) e Rregullores synon administrimin efikas të procesit gjyqësor (“për hir të një gjykimi të drejtë e të shpejtë”), duke i dhënë Trupit Gjykses kompetencë diskrecionale për të bërë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera të Dhomave të Specializuara, ose në procese gjyqësore të përfunduara në gjykata të tjera në Kosovë, apo në sisteme gjyqësore të tjera që kanë lidhje me aspektet e kontestuara, duke shmangur kështu paraqitjen e provave që janë vërtetuar më parë në procese të tjera në bazë të provave të paraqitura në ato procese.⁵⁰ Në të njëjtën kohë, kur ushtron diskrecionin e vet, Trupi Gjykses

⁴⁸ Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 10.

⁴⁹ Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 12.

⁵⁰ KSC-BC-2020-05, F00191, Trupi Gjykses I, *Vendim për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera* (“Vendimi Mustafa”), 7 shtator 2021, publik, para. 9. Ngjashëm, ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on Accused’s Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts related to count one](#) (“Karadžić Decision”), 21 January 2014, para. 4; ICTR, *Prosecutor v. Bagosora et al.*, ICTR-98-41-A, Appeals Chamber, [Decision on Anatole Nsengiyumva’s Motion for Judicial Notice](#), 29 October 2010, para. 10.

duhet të sigurojë respektimin e të drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë dhe të shpejtë, në përputhje me rregullën 157(2) të Rregullores.⁵¹

24. Gjatë ushtrimit të kompetencës diskrecionale, Trupi Gjykses ndër të tjera shqyrtoi nëse secili fakt përmbush kriteret në vijim: (i) faktet e propozuara nuk kanë lidhje me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit të përshkruara në akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar, dhe kanë të bëjnë me pika të kontestuara në këtë proces, sikurse përcaktohet në rregullën 157(2) të Rregullores; (ii) faktet e propozuara janë të dallueshme, konkrete dhe të identifikueshme;⁵² (iii) faktet e propozuara, ashtu siç janë formuluar nga pala parashtruese, nuk ndryshojnë në asnjë mënyrë thelbësore nga formulimi i tyre në aktgjykimin original;⁵³ (iv) faktet e propozuara nuk janë të paqarta apo çorientuese në kontekstin në të cilin janë paraqitur në mocionin e palës parashtruese;⁵⁴ (v) faktet e propozuara nuk përmbajnë konstatime ose cilësime juridike;⁵⁵ (vi) faktet e propozuara nuk bazohen në marrëveshje midis palëve në proceset origjinale;⁵⁶ dhe (vii) faktet e propozuara nuk janë në proces apeli apo

⁵¹ Vendimi Mustafa, para. 9.

⁵² Vendimi Mustafa, para. 10. Ngjashëm, ICTY, *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-PT, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts Concerning Sarajevo](#), 26 June 2008, para. 18; *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-PT, Trial Chamber II, [Decision on Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts Pursuant to Rule 94\(b\)](#), 14 March 2006, para. 12 ("Prlić Decision"); *Prosecutor v. Hadžihasanović & Kubura*, IT-01-47-T, Trial Chamber II, [Decision on Judicial Notice of Adjudicated Facts Following the Motions Submitted by Counsel for the Accused Hadžihasanović and Kubura on 20 January 2005](#), 14 April 2005, f. 5 ("Hadžihasanović Decision").

⁵³ Vendimi Mustafa, para. 10. Ngjashëm, ICTY, *Karadžić* Decision, para. 6; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber II, [Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts with Annex](#), 26 September 2006, para. 7 ("Popović Decision on Adjudicated Facts"); *Prosecutor v. Blagojević & Jokić*, IT-02-60-T, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts and Documentary Evidence, 19 December 2003](#), para. 16 ("Blagojević Decision").

⁵⁴ Vendimi Mustafa, para. 10. Ngjashëm, ICTY, *Popović* Decision on Adjudicated Facts, para. 8.

⁵⁵ Vendimi Mustafa, para. 10. Ngjashëm, ICTY, *Popović* Decision on Adjudicated Facts, para. 10; *Prlić* Decision, para. 12; *Hadžihasanović* Decision, f. 5; *Blagojević* Decision, para. 16.

⁵⁶ Vendimi Mustafa, para. 10. Ngjashëm, ICTY, *Prosecutor v. Krajišnik*, IT-00-39-PT, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution Motions for Judicial Notice of Adjudicated Facts and for Admission of Written Statements of Witnesses Pursuant to Rule 92 bis](#), 28 February 2003, para. 14; *Popović* Decision on Adjudicated Facts, para. 11.

rishikimi.⁵⁷ Duke bërë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera, Trupi Gjykses konfirmon prezumimin e bazuar mirë në lidhje me saktësinë e këtyre fakteve, të cilat rrjedhimisht nuk ka nevojë të provohen përsëri në gjykim.⁵⁸ Duke qenë se është prezumim i kundërshtueshëm, pala tjetër mund të paraqesë në gjykim prova që kundërshtojnë saktësinë e këtyre fakteve.⁵⁹

25. Pasi ka shqyrtuar secilin nga faktet e propozuara veç e veç kundrejt kriterëve të përcaktuara më lart, dhe pasi ka shqyrtuar argumentet dhe parashtrimet e palëve, Trupi Gjykses konstaton si vijon.

26. Së pari, Trupi Gjykses është bindur se faktet e shqyrtuara të propozuara 1-31, 33-51, 55-56, 59 dhe 60– sipas formulimit aktual të tyre në Kërkesën e ZPS-së – përmbushin kriteret e lartpërmendura. Sa u përket fakteve të shqyrtuara të propozuara 32 dhe 53, Trupi Gjykses, në bazë të kompetencës së vet diskrecionale, i ka riformuluar ato *proprio motu*, duke shtuar ose hequr disa fraza të caktuara, në mënyrë që formulimi i tyre të jetë sa më afër konstatimeve origjinale dhe për të eliminuar çfarëdo paqartësie të mundshme në lidhje me konstatimet e bëra në ato aktgjykime.⁶⁰ Trupi Gjykses i referohet Shtojcës 2 të këtij vendimi, ku faktet e propozuara 32 dhe 53 të shqyrtuara në procese të tjera janë përfshirë të riformuluara nga Trupi Gjykses në Shtojcën 2 të këtij vendimi.

⁵⁷ Vendimi Mustafa, para. 10. Ngjashëm, ICTY, *The Prosecutor v. Ratko Mladić*, IT-09-92, Appeals Chamber, [Decision on Ratko Mladić's Appeal Against the Trial Chamber's Decisions on the Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts](#), 12 November 2013, para. 92, 94; Popović Decision on Adjudicated Facts, para. 14.

⁵⁸ Vendimi Mustafa, para. 11. Ngjashëm, ICTY, *Prosecutor v. S. Milošević*, IT-02-54-AR73.5, Appeals Chamber, [Decision on the Prosecution's Interlocutory Appeal against the Trial Chamber's 10 April 2003 Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts](#), 28 October 2003, f. 3; Karadžić Decision, para. 5; SCSL, *Prosecutor v. Issa Hassan Sesay, Morris Kallon and Augustine Gbao*, SCSL-04-15-T, Trial Chamber I, [Decision on Sesay Defence Application for Judicial Notice to be taken of Adjudicated Facts under Rule 94\(b\)](#), 23 June 2008, para. 18.

⁵⁹ Vendimi Mustafa, para. 11, 14.

⁶⁰ Për lehtësi referimi, riformulimet *proprio motu* të Trupit Gjykses janë shkruar me të kuqe në Shtojcën 2 të këtij vendimi.

27. Trupi Gjykues vlerëson se faktet e shqyrtuara në procese të tjera që propozohen (përkatësisht faktet 1-51, 53, 55-56, 59-60), sikurse janë parashtruar nga ZPS-ja ose riformuluar nga Trupi Gjykues, janë relevante për këtë çështje gjyqësore, sepse ato, ose: (a) lidhen me ekzistencën e konfliktit të armatosur midis UÇK-së dhe forcave të ish-Republikës Federale të Jugosllavisë që luftonin së bashku me forcat e Serbisë, ndër të cilat njësi të Ushtrisë së Republikës Federale të Jugosllavisë (*në serbishte: Vojska Jugoslavije* ose “VJ”; *në shqipe: Ushtria e Jugosllavisë* ose “UJ”) dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (*në serbishte: Ministarstvo Unutrasnjih Poslova* ose “MUP”; *në shqipe: Ministria e Punëve të Brendshme* ose “MPB”);⁶¹ (b) ofrojnë informacion kontekstual për akuzat në këtë çështje gjyqësore;⁶² (c) kanë të bëjnë me vendin e pretenduar të krimit dhe ofrojnë informacion relevant për disa krime të kryera aty;⁶³ ose (d) lidhen me rolin brenda UÇK-së të anëtarëve të pretenduar të NKP-së, përveç të akuzuarit.⁶⁴ Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes, Trupi Gjykues është bindur se faktet e lartpërmendura nuk lidhen me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit. Trupi Gjykues gjithashtu gjykon se konstatimi gjyqësor i fakteve të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera, përmendur më lart, është në interes të drejtësisë dhe të një gjykimi të drejtë e të shpejtë. Trupi Gjykues rithekson në këtë kontekst se konstatimi gjyqësor i fakteve të shqyrtuara në procese të tjera krijon prezumim të kundërshtueshëm të saktësisë së atyre fakteve.⁶⁵ Kjo nuk eliminon detyrimin e provës që ka ZPS-ja për të provuar akuzat jashtë dyshimit të arsyeshëm. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues bën konstatim gjyqësor të fakteve 1-51, 53, 55-56 dhe 59-60, në përputhje me formulimet në Shtojcën 2 të këtij vendimi.

⁶¹ Faktet e Propozuara 1-29 dhe 34-50.

⁶² Faktet e Propozuara 30-33.

⁶³ Faktet e Propozuara 51, 53, dhe 55-56.

⁶⁴ Faktet e Propozuara 59-60.

⁶⁵ *Shih, ngjashëm*, KSC-BC-2020-06, F01534, Trupi Gjykues II, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale, para. 26.

28. Sa u përket fakteve të tjera të shqyrtuara të propozuara, (përkatësisht faktet 52, 54, 57, 58 dhe 61), Trupi Gjykses refuzon të bëjë konstatim gjyqësor të tyre për arsye në vijim.

29. Së pari, në lidhje me faktet e shqyrtuara të propozuara 52 dhe 54, Trupi Gjykses gjykon se formulimi që propozon ZPS-ja devijon thelbësisht nga formulimi i përdorur në aktgjykimet përkatëse. Më konkretisht, në lidhje me faktin e shqyrtuar të propozuar 52, shpjegimet e ZPS-së në poshtëshënimet 2 dhe 3 të Shtojcës 2 të Kërkesës së ZPS-së nuk e ndihmuan Trupin Gjykses. Në lidhje me faktin 54 të propozuar si fakt i shqyrtuar në procese të tjera, Trupi Gjykses konstaton se riformulimi që propozon ZPS-ja devijon kaq thelbësisht nga konstatimet origjinale, saqë Trupi Gjykses nuk mendon se ato janë të shqyrtuara në kuptimin e vërtetë të fjalës.⁶⁶ Përgjithësisht, Trupi Gjykses vlerëson se faktet e shqyrtuara të propozuara 52 dhe 54 nuk do ta ndihmojnë në detyrën e zbardhjes së fakteve dhe rrjedhimisht refuzon të bëjë konstatim gjyqësor të tyre.

30. Së dyti, në lidhje me faktin e shqyrtuar të propozuar 57, Trupi Gjykses gjykon se ashtu siç është formuluar, ai nuk ofron kontekst dhe qartësi të mjaftueshme për qëllimet e këtij gjykimi. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses refuzon të bëjë konstatim gjyqësor të tij.

31. Së treti, në lidhje me faktin e shqyrtuar të propozuar 58, Trupi Gjykses gjykon se, ashtu siç është formuluar aktualisht, për këtë fakt nuk është dhënë vendim i qartë në aktgjykimin origjinal , veçanërisht në lidhje me kuadrin kohor të propozuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses refuzon të bëjë konstatim gjyqësor të tij.

32. Së fundi, sa i përket faktit të shqyrtuar të propozuar 61, Trupi Gjykses vëren se termi “torturë” përmban qartësisht një cilësim juridik. Përveç kësaj, fakti i propozuar

⁶⁶ *Shih*, në lidhje me këtë, *Popović* Decision on Adjudicated Facts, para. 7-8 dhe referencat shoqëruese në poshtëshënimin 25.

nuk është mjaftueshmërisht specifik sa i përket kuadrit kohor të ngjarjeve. Së fundi, Trupi Gjykues ushtron kompetencën e tij diskrecionale dhe refuzon të bëjë konstatim gjyqësor të këtij fakti të propozuar, i cili lidhet me sjelljen (dhe jo rolin) e anëtarëve të pretenduar të NKP-së, të përshkruar në akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar.

V. VENDIM

33. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a. **MIRATON** Kërkesën e ZPS-së, pjesërisht;
- b. **BËN** konstatim gjyqësor të fakteve 1–17 të propozuara si fakte të njohura nga gjithkush, sikurse përcaktohet në Shtojcën 1 të këtij vendimi;
- c. **BËN** konstatim gjyqësor të fakteve 1-51, 53, 55-56, dhe 59-60 të propozuara si fakte të shqyrtuara në procese të tjera, sikurse janë formuluar në Shtojcën 2 të këtij vendimi;
- d. **REFUZON** të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve 52, 54, 57-58 dhe 61, të propozuara si fakte të shqyrtuara në procese të tjera;
- e. **URDHËRON** ZPS-në që deri të **premtën, 16 qershor 2023**, të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Shtojcës 2 të Kërkesës së ZPS-së; dhe
- f. **URDHËRON** Mbrojtjen që deri të **premtën, 23 qershor 2023**, të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Shtojcës 2 të Përgjigjes së Mbrojtjes, duke mbajtur parasysh redaktimet e zbatuara nga ZPS-ja.

/nënshkrimi/
Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/
Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/
Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 8 qershor 2023

Në Hagë, Holandë.